

## **Behxhet Shala,**

*drejtor ekzekutiv i KMDLNJ*

### **PRIVATIZIMI NË KOSOVË**

- *Roli i organeve lokale të pushtetit, përkatësisht i institucioneve të përkohshme të Kosovës, në procesin e deritashëm të privatizimit, në kuptimin praktik dhe operativ, është aq i marginalizuar sa ato, në rastin më të mirë, mund të shfaqin mendimet dhe të paraqesin qëndrimet e veta, por, nëse ato nuk janë në pajtim me mendimet dhe qëndrimet e aktorëve ndërkombëtarë, nuk e obligojnë me asgjë as UNMIK-un as Agjencinë Kosovare të Mirëbasimit - kompetente për implementimin e këtij procesi*
- *Ndërmarrjet shoqërore tash më se katër vjet janë "ngrirë" nga ana e UNMIK-ut pa kurrfarë mbështetjeje ose përkrahjeje ndërkohë që punëtorët e tyre, tash një kohë të gjatë, jetojnë me frikë se kur do të shpallet tenderi për privatizimin e ndërmarrjeve të tyre dhe çfarë do të jetë fati i tyre*
- *Kumtesë e lexuar në seminarin ndërkombëtar të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare Ortodokse Bamirëse IOCC në Beograd mbi kolizionin e akteve ligjore dhe procesin e privatizimit në Kosovë*

Procesi i privatizimit të suksesshëm, i cili është parakusht për zhvillimin e ekonomisë moderne të tregut, hapja e vendeve të reja të punës dhe fitimi i së drejtës për anëtarësim në integrimet evropiane gjithsesi është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet Kosova e pasluftës dhe me të cilat, sipas të gjitha gjasëve, do të ballafaqohet edhe një kohë.

Kosova, si dihet, është rajon ku ka filluar më së voni procesi i privatizimit në Evropë. Është e vërtetë se edhe në Kosovën e paraluftës ka qenë instaluar rregullativa e caktuar ligjore për fillimin dhe zbatimin e këtij procesi aq qenësor, por, për shkak të rrethanave të njohura, që nuk janë temë e kësaj fjale, më shumë se një dekadë praktikisht ka vendnumëruar.

Si në të gjitha rajonet e ish-RSFJ, edhe në Kosovë, vetëm pas proceseve të njohura të ndryshimeve, deri diku janë krijuar kushtet që të fillojë procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Edhe në këtë pikëpamje, pra edhe në pikëpamje të fillimit dhe të zbatimit të procesit të privatizimit, Kosova është rajon karakteristik jo vetëm në Ballkan, por lirisht mund të themi, edhe në Evropë dhe në botë.

Nëse për asgjë tjetër, atëherë për faktin se procesin e privatizimit po e implementon Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ku, roli i organeve lokale të pushtetit, përkatësisht i institucioneve të përkohshme të Kosovës, në kuptimin praktik dhe operativ, është aq i marginalizuar sa ato, në rastin më të mirë, si anëtarë të organeve të caktuara (p.sh. anëtarë të Këshillit të Drejtorëve të AKM) mund të shfaqin mendimet dhe të paraqesin qëndrimet e veta, të cilat, nëse nuk janë në pajtim me mendimet dhe qëndrimet e aktorëve ndërkombëtarë, nuk e obligojnë absolutisht me asgjë UNMIK-un dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbasimit (AKM).

### **A e kanë përcaktuar UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të Kosovës bazën juridike për fillimin e procesit të privatizimit**

Në këtë situatë, dalin në sipërfaqe disa çështje shumë interesante, të cilat do të provojmë t'i elaborojmë në këtë ekspozitë.

- Së pari shtrohet çështja që kemi përmendur në temën rreth kolizionit të dispozitave juridike. Të gjitha Rregulloret e nxjerra deri tash, duke përfshirë edhe Rregulloret mbi privatizimin në Kosovë, në preambulat e veta mbështeten në autorizimet e dhëna Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSPKB) në Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB të 10 qershorit të vitit 1999.

Në këtë Rezolutë, në pikën 2, numërohen në mënyrë taksative detyrat themelore të UNMIK-ut, e në kuadrin e kësaj pike, vetëm në një rast përmenden detyrat e UNMIK-ut në fushën e ekonomisë - të definuara si "detyrë për mbështetjen e rikonstruktimit të infrastrukturës dhe të ekonomisë".

A e nënkupton obligimi i cituar i UNMIK-ut edhe inicimin dhe zbatimin e procesit të privatizimit? Ndoshta kjo mund të interpretohet edhe në këtë mënyrë meqenëse ka shumë "hapësirë të zbrazët" për interpretime të ndryshme, por konsiderojmë se këtij obligimi të UNMIK-ut do t'i përgjigjej më tepër ndërmarrja e hapave konkretë në formë të nxjerrjes së akteve ligjore dhe të instrumenteve ndihmëse për implementimin praktik të tyre, të cilat, për në fillim, do të shërbenin si mbështetje për riaktivizimin e reparteve të shumta prodhuese në Kosovë që kanë mbetur të zbrazëta tash më shumë se katër vjet, për përcaktimin e lehtësive për sigurimin e repromaterialit, për krijimin e një konkurrence të shëndoshë në treg, për pamundësimin e çfarëdo llojesh të monopolit, për krijimin e kushteve për eksportimin e balancuar të produkteve të vendit dhe për importimin e produkteve të huaja. etj.

Megjithëse ekonomia e Kosovës është në degët më të ulëta, mund të themi se prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, prapëseprapë, ajo ka reparte prodhuese e ndërmarrje shoqërore të cilat, menjëherë pas përfundimit të operacioneve të luftës në Kosovë, e kanë filluar me sukses procesin e rivitalizimit dhe të prodhimit pa kurrfarë mbështetjeje ose përkrahjeje. Fjala është, për shembull, për Fabrikën e Birrës në Pejë ose Fabrikën e Materialit Ndërtimor në Gjakovë. Në vend që këtyre dhe fabrikave të ngjashme t'u jepej mbështetja përkatëse për vazhdimin dhe zhvillimin e prodhimit, ndodh që punëtorët e këtyre fabrikave, tash një kohë të gjatë, të jetojnë me frikë se kur do të shpallet tenderi për privatizimin e ndërmarrjeve të tyre shumë të suksesshme dhe çfarë do të jetë fati i tyre.

Jo vetëm këto ndërmarrje, por të gjitha ndërmarrjet shoqërore tash më se katër vjet janë "ngrirë" nga ana e UNMIK-ut pa kurrfarë mbështetjeje ose përkrahjeje. Vetëm nëse dhënia me qira e disa lokaleve të tyre do të mund të quhej mbështetje ose përkrahje punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve dhe formë e të ashtuquajturit "komercializim" të tyre që kursesi nuk do të thotë privatizim i tyre.

Është e qartë se "pronësia shoqërore" është nocion i panjohur për bashkësinë ndërkombëtare për shumë shkaqe të arsyeshme. Mirëpo, duhet pasur parasysh se edhe "pronësia shoqërore", si e këfillë, në Kosovë nuk është konstituuar dhe ose pardje, por, praktikisht, ajo ka qenë formë themelore e pronësisë në gjashtëdhjetë vjetët e fundit prej nga kanë dalë marrëdhënie të shumta që janë rrënjësor në vetëdijen e qytetarëve të Kosovës dhe jo vetëm të Kosovës. Fundja, duhet pasur parasysh faktin se pronësia shoqërore, deshëm apo s'deshëm ta pranojmë këtë, ka paraqitur një kohë të gjatë formën themelore ekzistenciale për qytetarët e Kosovës dhe të mbarë këtij rajoni. Në këtë pikëpamje, konsiderojmë se "ngrirja" e këtyre ndërmarrjeve në Kosovë brenda më se katër vjetëve dhe eliminimi total i tyre nga çfarëdo përkrahje materiale, profesionale ose së paku morale, është një nga gabimet e administratës së UNMIK-ut së bashku edhe me institucionet lokale të pushtetit në Kosovë. Nuk konsiderojmë se dhënia eventuale e përkrahjes së vogël këtyre ndërmarrjeve do të mund të karakterizohej si mbështetje pronësisë shoqërore. Përkundrazi. Me këtë, megjithatë, do të zbutej situata shumë e vështirë ekonomike në Kosovë. Supozojmë se në këto rrethana të reja edhe procesi i privatizimit do të zhvillohej më lehtë dhe nuk do të vinim në situatë ku, sipas raporteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, papunësia e popullsisë ka arritur shifrën tragjike prej afro 60%.

-Çështja tjetër që shtrohet është a e kanë përcaktuar UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të Kosovës bazën juridike për fillimin e procesit të privatizimit, përkatësisht a është krijuar infrastruktura e kënaqshme ligjore për këtë?

Duke bërë krahasimin me legjislacionet pozitive të shteteve të tjera që e kanë filluar më herët privatizimin, mund të vihet në përfundim se edhe në këtë fushë situata në Kosovë është specifike.

Në krahasim me vendet përreth, përkatësisht me bazat e konstituara juridike të tyre të procesit të privatizimit, vërehet rregullativa mjaft e ngushtuar juridike për zbatimin e privatizimit në Kosovë.

Në Republikën e Serbisë, për shembull, në favor të procesit të privatizimit janë 6 akte ligjore dhe më se 10 akte nënligjore. Në Republikën e Kroacisë procesin e privatizimit e rregullojnë rreth 20 ligje, kurse në Federatën e Bosnjës e të Hercegovinës 3 ligje dhe me dhjetëra akte nënligjore.

Në Kosovë ka filluar procesi i privatizimit, e Kosova nuk ka ligj mbi privatizimin. Tërë baza juridike për fillimin, zbatimin dhe, supozoj, përfundimin e procesit të privatizimit në Kosovë, përbëhet nga këto akte:

- Rregullorja nr. 2002/12, datë 13 qershor 2002, mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe

- Rregullorja nr. 2002/13, datë 13 qershor 2002, mbi formimin e Këshillit të Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Përpos këtyre akteve, ku Rregullorja 2002/13 nuk përmban dispozita që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me procesin e privatizimit, por përcaktojnë mënyrën e zgjidhjes së kontesteve eventuale gjyqësore, në mënyrë indirekte, në infrastrukturën ligjore të këtij procesi mund të numërohen edhe:

- Rregullorja nr. 2001/3, datë 12 janar 2001, mbi investimet e huaja në Kosovë dhe
- Rregullorja nr. 2003/13, datë 9 maj 2003, mbi transformimin e së drejtës së shfrytëzimit të patundshmërive në pronësi shoqërore.

### **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me pushtet të pakufizuar mbi të gjitha ndërmarrjet shoqërore e publike**

Nga të gjitha aktet e përmendura, rolin kyç, për të mos thënë edhe të vetëm, e ka Rregullorja nr. 2002/12, datë 13 qershor 2002, mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është formuar si organ i mëvetësishëm dhe i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës. "Agjencia ka statusin e personit juridik dhe veçmas ka aftësinë e lidhjes së kontratave, fitimit, ruajtjes dhe shitjes së pasurisë si dhe të kompetencës që nënkuptohet në pikëpamje të kryerjes së detyrave dhe të kompetencave të dhëna me këtë Rregullore, si dhe që të padisë dhe të jetë e paditur". (Citat nga neni 1 i Rregullores së përmendur).

Të 23 kompetencat e AKM janë të numëruara në mënyrë taksative në nenin 6, pika 1 e 2 e Rregullores së përmendur. Për të pasur një pasqyrë më të mirë të autorizimeve të AKM, po përmendim disa prej tyre:

- Emërimi dhe ndërrimi i drejtorit, i kryesuesit apo udhëheqësit të ndërmarrjes;
- Emërimi, konfirmimi ose ndryshimi i përbërjes së të gjithë trupave udhëheqës në ndërmarrje;
- Ndryshimi i autorizimeve të cilitdo nga trupat e përmendur;
- Ndërmarrja e kontrollit të drejtpërdrejtë të ndërmarrjes, duke përfshirë kontot dhe aktivën e ndërmarrjes dhe drejtimin e tyre si dhe disponimin e parave dhe të aktivës tjetër të ndërmarrjes;
- Inicimi i procesit të bankrotimit dhe likuidimit të ndërmarrjes etj.

Kjo, praktikisht, do të thotë se AKM ka pushtet të pakufizuar mbi të gjitha ndërmarrjet shoqërore e publike, se është i vetmi titullar i pushtetit në këto ndërmarrje dhe se diapazoni praktik i autorizimeve të AKM nisat nga emërimi i pastruesve deri te privatizimi komplet i ndërmarrjeve të përmendura dhe se organet e qeverisjes në ndërmarrje janë vetëm të natyrës formale, të privuara prej çfarëdo autorizimesh më të qenësishme.

Struktura organizative e AKM është si vijon:

- Këshilli i dektorëve,
- Drejtori i Menaxhmentit ose Menaxheri,
- Dy zëvendës të Drejtorit të Menaxhmentit ose të Menaxherit dhe
- Personeli profesional e teknik.

Këshilli i Drejtorëve përcakton parimet e politikës operative për udhëheqjen e Agjencisë me ushtrimin e kompetencave të veta. Veprimtaria dhe procedura e punës së Këshillit përcaktohet me Statutin e Këshillit.

Këshillin e Drejtorëve e përbëjnë 8 anëtarë (4 ndërkombëtare dhe 4 lokalë). Anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit janë të caktuar me nenin 12.3 të Rregullores dhe këta janë:

Zëvendësi i PSSPKB për rikostruktim ekonomik i cili njëkohësisht është edhe Kryetar i Këshillit, Zëvendësi i Zëvendësit të PSSPKB për rikostruktim ekonomik, Zëvendësi i PSSPKB për administratë civile dhe Drejtori i Menaxhmentit ose Menaxheri. Të gjithë i përgjigjen drejtpërdrejt PSSPKB.

Katër anëtarët lokalë të Bordit, gjithsesi, i emëron PSSPKB, nga të cilët njëri është Zëvendës i Kryetarit të Bordit. Tre anëtarë lokalë janë ministrat e ministrive përkatëse të Qeverisë së Kosovës, kurse i katërti është Kryetari i Unionit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Këshilli i merr vendimet e veta me konsensus. Në qoftë se nuk ka konsensus, bëhet votimi dhe secili anëtar ka një votë. Mbase është e tepërt të thuhet se në rast se numri i votave është i barabartë, atëherë mbizotëron vota e Kryetarit të Bordit

Kompetencat e Këshillit janë të përcaktuara me nenin 15 të Rregullores në 19 pika, nga të cila po veçojmë:

- Këshilli në përgjithësi është përgjegjës për aktivitetin e Agjencisë dhe, në këtë pikëpamje, ndërmerr cilindo aksion që e kërkon Rregullorja;
- Miraton direktivat operative sipas nenit 10 të Rregullores (direktivat që kanë të bëjnë me ushtrimin e autorizimeve të veta);
- Emëron ose pushon menaxherin dhe zëvendësit e tij;
- Vendos ndërmarrjet nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë;
- Miraton planet për riorganizimin e ndërmarrjeve;
- Shet ose bën transferin e pjesës ose të të gjitha pjesëve të shoqërisë aksionare;
- Vendos për likuidimin;
- Miraton buxhetin dhe planin e punës së Agjencisë etj.

Drejtorin e Menaxhmentit ose Menaxherin e Agjencisë e emëron Këshilli me propozimin e Kryetarit të vet. Detyra e Menaxherit dhe e zëvendësve të tij është zbatimi praktik i vendimeve të Këshillit. Kompetencat e Menaxherit dhe të zëvendësve të tij janë të përcaktuara me nenin 16 të Rregullores, nga të cilat po veçojmë:

- Ushtrimin e të gjitha funksioneve që ua beson Këshilli,
- Zbatimin e punëve të rregullta të Agjencisë në pajtim me direktivat e Këshillit;
- Paraqet raporte dhe i përgjigjet Këshillit etj.

Këto do të ishin karakteristikat themelore të AKM.

Pas gjithë kësaj, e sidomos pas analizës së hollësishme të të gjitha neneve të Rregullores 2002/12, datë 13 qershor 2002, mund të konkludohet se tërë procesi i privatizimit në Kosovë praktikisht është kompetencë ekskluzive e një njeriu – PSSPKB nëpërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në favor të kësaj flet edhe neni 24, pika 2 e Rregullores, sipas të cilës "Këshilli kolektivisht dhe individualisht i përgjigjet PSSPKB për harmonizimin e punës së Agjencisë me: Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me dispozitat e kësaj Rregullore dhe me dispozitat e tjera që mund t'i nxjerrë PSSPKB në lidhje me këtë Rregullore, me cilindo ligj në fuqi në Kosovë dhe akt themelues, dispozita, direktiva operative, financiare e personale dhe veprime afariste të Agjencisë".

## **A do të mbetet statusi i mëtejshëm e punëtorëve në mëshirën e blerësve të ndërmarrjeve të tyre**

-Çështje tjetër që shtrohet është procedura e zbatimit të privatizimit. Kjo procedurë është rregulluar me aktin juridik intern të AKM të quajtur "Procedura e tenderimit për privatizim të tipit Spin – Off". Me këtë akt juridik rregullohet tërë procedura praktike e privatizimit në të gjitha fazat.

Ky akt intern përbëhet nga 15 nene ose pika në afërsisht 10 faqe të shtypura. Me këto rregullohen të gjitha veprimet praktike prej pikës kush mund të marrë pjesë në tender e deri te përmbajtja dhe dorëzimi i ofertave dhe lidhja e marrëveshjes me shkrim me blerësin rreth privatizimit të ndërmarrjes shoqërore. Në këtë akt janë të përcaktuara edhe të ashtuquajturat "kompetenca të rezervuara të AKM" në procedurën praktike të privatizimit.

Specificitetet themelore të metodës së privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (Spin – Off) janë të përcaktuara në nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12, ku AKM, në emër të ndërmarrjes shoqërore, mund të themelojë një ose më shumë shoqëri aksionare dhe në këto shoqëri të bartë të drejtat dhe interesat në raport me tërë aktivën ose me pjesë të aktivës së ndërmarrjes përkatëse shoqërore. Pjesët e shoqërisë apo të shoqërive aksionare të themeluara në këtë mënyrë i posedon ndërmarrja shoqërore përkatëse dhe ato i qeveris AKM konform nenit 6 të Rregullores.

Në fazën e dytë, AKM, në emër të ndërmarrjes përkatëse shoqërore, mund t'ua shesë ose të bartë një pjesë ose të gjitha pjesët e shoqërisë aksionare investuesve privatë ose juridikë (të vendit ose të huaj).

Të hyrat nga shitja e një pjese ose të të gjitha pjesëve nga alineja e sipërme i qeveris AKM, midis të tjerash, në favor të kreditorëve të ndërmarrjes shoqërore.

Duhet ditur gjithashtu se AKM qeveris në tërësi gjithsej 55 ndërmarrje publike në Kosovë, siç janë, për shembull, Korporata Energjetike e Kosovës, Post Telekom i Kosovës, ekonomia e ujërave, komunikacioni ajror e hekurudhor etj., të cilat, gjithsesi, nuk hyjnë në procesin e privatizimit, respektivisht ku mund të hyjnë vetëm disa pjesë përbërëse të tyre.

-Duhet pasur parasysh edhe një çështje, e kjo është çështja e statusit të punëtorëve të atyre ndërmarrjeve që janë privatizuar ose që do të privatizohen.

Punëtorët e punësuar në këto ndërmarrje kanë të drejtë individuale ose grupore që të konkurrojnë në tenderin e shpallur. Pra, individit, grupit të punëtorëve ose tërë kolektivit u garantohet e drejta që, nëse kanë mjete financiare, të paraqesin oferta për privatizimin e ndërmarrjes në të cilën kanë punuar. Nëse nuk gabojmë, deri tash kemi pasur një rast të tillë në praktikë, kur punëtorët e kanë privatizuar ndërmarrjen "Termosistemi" në Rahovec në rundin e parë të privatizimit.

Ky nuk është privilegj, por e drejtë të cilën e ka çdo qytetar, përkatësisht çdo person fizik ose juridik. I vetmi privilegj që u është dhënë punëtorëve është në rastin kur oferta e tyre është identike me ofertën ose ofertat e tjera. Në këtë rast, përparësi ka oferta e punëtorëve. Por, mund të pajtohem se kjo mundësi ekziston vetëm në domenin teorik.

Në të kundërtën, statusi i mëtejshëm e punëtorëve mbetet në mëshirën e blerësve të ndërmarrjes. I vetmi "ngushëllim" për këta punëtorë mund të jetë fakti se atyre u takojnë 20% të çmimit të arritur, që u ndahen këtyre punëtorëve sipas parametrave të caktuar.

Listën e punëtorëve që kanë të drejtën e kompensimit e përcakton definitivisht AKM pasi ta ketë marrë listën e përbashkët të vërtetuar të të punësuarve nga ana e përfaqësuesve të të punësuarve të ndërmarrjes përkatëse dhe të Sindikatës së Pavarur të Kosovës.

Punëtor i punësuar që ka të drejtën e kompensimit konsiderohet punëtor i regjistruar si i punësuar në ndërmarrje në kohën e privatizimit dhe në qoftë se emri i tij gjendet në listën e rrogave në atë ndërmarrje në periudhën prej së paku tre vjetësh. Punëtorët e tjerë, që nuk janë të kënaqur me këta parametra ose që nuk i plotësojnë këto kushte, e që konsiderojnë se u takon e drejta e kompensimit, mund t'i paraqesin ankesën e tyre Këshillit të Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të themeluar me Rregulloren nr. 2002/13, datë 13 qershor 2002.

Autorizimi për pagesën e kompensimit punëtorëve të cilëve u takon kjo e drejtë i është dhënë Sindikatës së Pavarur të Kosovës, të cilën AKM e ngarkon me shumën e nevojshme të parave nga kontoja e vet e veçantë. Pagesa e këtij kompensimi bëhet sipas këtij kriteri:

- 75% të këtyre mjeteve ndahen dhe paguhen në shuma të njëjta për secilin punëtor;
- 25% u ndahen punëtorëve proporcionalisht me stazhin e punës që kanë ata, pra secili veç e veç, në atë ndërmarrje.

Pra, blerësi i ndërmarrjes, qoftë ai person fizik apo juridik, nuk është i obliguar në asnjë mënyrë që t'i ndalë punëtorët në marrëdhënie pune. A do ta ndalë ose jo ndonjërin punëtor varet ekskluzivisht nga planet e tij, vullneti dhe dëshira e tij.

## **Cilat janë rezultatet praktike të procesit të realizuar deri tash të privatizimit në Kosovë**

Aplikimi praktik i dispozitave të pjeshme dhe të centralizuara që e rregullojnë procesin e privatizimit ka filluar gjatë vitit 2003. Janë mbajtur dy runde të privatizimit. Në rundin e parë, më 14 korrik 2003, janë tenderuar 5 e janë privatizuar 4 ndërmarrje, kurse në rundin e dytë, më 3 shtator 2003, janë tenderuar 19 e janë privatizuar 18 ndërmarrje, që do të thotë se janë tenderuar 24, nga të cilat janë privatizuar 22 ndërmarrje.

Në këtë vështrim, dëshirojmë të theksojmë një fakt të hidhur se investitorë e dhe blerës të huaj nuk janë të interesuar të inkuadrohen në procesin e privatizimit. Në favor të këtij konstatimi flet edhe fakti se, me pak përjashtime, asnjë person i huaj as nuk ka marrë pjesë, përkatsisht nuk ka bërë ofertë për privatizimin e ndërmarrjeve në asnjërin nga dy rundet e mbajtura. Shkaqe kryesore të kësaj abstinence të investitorëve të huaj me siguri janë statusi i padefinuar i Kosovës, mungesa e infrastrukturës së tërësishme ligjore mbi investimet e huaja, kolizioni i dispozitave juridike dhe mungesa e sistemit efikas të sigurimit të kredive. Në këso kushtesh ka qenë fare reale të pritët mungesa e investitorëve të huaja të cilët në asnjë mënyrë nuk dëshirojnë ta rrezikojnë kapitalin e tyre.

Përpos kësaj, çmimet e realizuara për 22 ndërmarrje shoqërore të privatizuara deri tash, shikuar realisht, janë të ulëta. Për më tepër, nëse krahasohen me çmimet që janë në procesin e privatizimit në vendet përreth, çmimet në Kosovë janë qesharake. Për shembull, hoteli "Adriatik" në Mitrovicë,

që gjendet në qendër të qytetit dhe ka rreth 50 dhoma për bujtje dhe infrastrukturë përcjellëse të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë hoteliere, është privatizuar me çmim pak më shumë se 400.000 euro.

Çmimi më i lartë në dy rundet e para është arritur rreth 2.500.000 euro për privatizimin e fabrikës "Plastika" në Prishtinë.

Duke krahasuar çmimet e arritura të privatizimit në Kosovë me ato në vendet përreth, konkretisht me ato në Serbi, do të shohim ndryshime drastike në një rast konkret. Për Industrinë e Duhanit në Gjilan, tenderi i të cilës është anuluar për shkak të numrit të pamjaftueshëm të ofertave, çmimi më i lartë i arritur ishte rreth 500.000 euro. Afërsisht në të njëjtën kohë, Industria e Duhanit në Nish, me kapacitet vërtet më të lartë se ajo e Gjilanit, sipas njohurive tona, është shitur për afro 400.000.000 euro. Çdo koment është i tepërt.

Ndërkaq, ajo që brengos më së tepërmi është situata momentale rreth procesit të filluar të privatizimit të ndërmarrjeve. Fatkeqësisht, ky proces momentalisht është ndalur, përkatësisht, është ndërperë.

### **Cilat shkaqe kanë ndikuar në ndërprerjen e procesit të privatizimit**

Për mungesë të transparencës në AKM, në opinion janë paraqitur variante të ndryshme të shkaqeve për ndërprerjen e procesit të privatizimit. Supozoj se autoritetet e Serbisë kanë ndikuar në këtë ndërprerje dhe se dikush ka bërë ankesë në Nju-Jork, etj. Rreth kësaj çështjeje janë mbajtur shumë debate si nga ana e institucioneve ndërkombëtare ashtu edhe nga ana e atyre lokale. Bordi i Drejtorëve i AKM, nga mbarimi i tetorit, ka mbajtur një mbledhje, në të cilën ka marrë vendim që, brenda një jave, të vazhdojë me rundin e tretë të privatizimit. Mirëpo, doli se këto ishin fjalë boshe.

Se situata, në këtë pikëpamje, është shumë serioze, flet edhe vizita e PSSPKB në Nju-Jork për konsultim pikërisht rreth kësaj teme.

Gjatë ndërprerjes së procesit të privatizimit, sipas mendimit tonë, janë kristalizuar dy shkaqe themelore të kësaj ndërprerjeje:

- Ligji mbi pasuritë në pronësi të Republikës së Serbisë ("Fletorja Zyrtare e RS", 53/95) dhe
- Kërkesa e kuadrit ndërkombëtar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për konstituimin e llojit të caktuar të imunitetit ndërkombëtar për të.

Sipas Ligjit të përmendur të RS, të gjitha pasuritë publike në territorin e Kosovës janë pronësi e Republikës së Serbisë. Kjo do të thotë se ato pasuri nuk mund të privatizohen në Kosovë, përkatësisht se privatizimin e tyre mund ta bëjnë vetëm organet kompetente të Serbisë.

Në këtë kontekst, situata është shumë e ngatërruar, meqenëse ky ligj kontestues edhe më tutje është në fuqi në Serbi dhe me asnjë akt tjetër nuk është vënë jashtë ligjit. Nga ana tjetër, roli i UNMIK-ut dhe autorizimi i tij në këtë drejtim edhe më tutje është shumë diskutabël. Lëmshi bëhet edhe më i ngatërruar nëse kihet parasysh pika 10 e preambulës së Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të KB, sipas të cilës, respektohen sovraniteti dhe integriteti territorial i RSJ (tash Unionit Serbi dhe Mali i Zxi) në territorin e të cilit praktikisht vlen edhe më tutje ligji kontestues.

Pra, mbetet të shihet, besojmë në një të ardhme të afërme, si do të zgjidhet ky problem.

Përpos kësaj, kërkesa e të punësuarve në AKM për konstituimin e "imunitetit ndërkombëtar" është shumë diskutabile dhe, në esencë, problematike që vështirë se mund të pranohet. Një lloj imuniteti tashmë është konstituuar në Kosovë. Në të vërtetë, me Rregulloren 2000/47, datë 18 gusht 2000, janë përcaktuar statusi, privilegjet dhe imuniteti i KFOR-it e i UNMIK-ut dhe i personelit të tyre

Për imunitetin e UNMIK-ut dhe të personelit të tij flet neni 3, pika 1 deri 5 e kësaj Rregulloreje.

Analog me interpretimin e dispozitave të Rregullores, edhe personeli i AKM, që është anëtar i UNMIK-ut dhe nën mbikëqyrjen e tij, gëzon privilegjet e përmendura si dhe imunitetin.

A nuk mjafton Rregullorja e përmendur për personelin e AKM ose kërkon autorizime më të mëdha dhe imunitet më të madh sesa kanë, për shembull, njësitë e KFOR-it, është pyetje e madhe. Pyetje është, në të vërtetë, cilat motive e kanë shtytur personelin e AKM që të kërkojë kësi imuniteti.

Kjo situatë e paqartë rreth ndërprerjes së procesit të privatizimit u ka shkaktuar dëme të mëdha personave që tashmë i kanë privatizuar ndërmarrjet në dy rundet e para. Janë paguar në tërësi çmimet shitblerëse, e në disa raste tashmë kanë filluar investime në këto ndërmarrje duke u

përgatitur për aktivizimin e prodhimit. Të gjithë blerësit kanë marrë kredi bukur të mëdha në banka dhe kështu mujore për pagesë kanë filluar të arrijnë ndërkohë që AKM ende nuk i ka përpiluar e jo më nënshkruar kontratat me blerësit. Blerësit vetëm për disa muaj janë dëmtuar rëndë dhe shumë prej tyre kanë paralajmëruar se do të ngrejnë padi kundër AKM konform me Rregulloren nr. 2002/13, datë 13 qershor 2002.

### **Sa është (de)bllokuar procesi i privatizimit në Kosovë**

Informacionet e fundit rreth vazhdimit të procesit të filluar të privatizimit janë shumë kontradiktore. Ndërsa anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit të Drejtorëve pohojnë se është gjetur zgjidhja për deblokimin e procesit, anëtarët lokalë konsiderojnë se pikërisht tash është bllokuar totalisht procesi i privatizimit në Kosovë. Nëse janë të sakta të dhënat se duhet të bëhet revidimi i tenderëve tashmë të përfunduar, atëherë gjithësesi është më afër realitetit vlerësimi i anëtarëve lokalë të Këshillit të Drejtorëve të AKM. Sido që të jetë, mbetet të shihet çka do të tregojë koha.

Si konkluzion imponohet mendimi se këto pasoja të mëdha negative, megjithëse procesi i privatizimit është mu në fillim, megjithatë, janë rezultat i fillimit të ngutshëm. Privatizimi, me këtë ndërprerje, ka marrë grusht veçanërisht të rëndë, pasojat e të cilit, jemi të bindur, do të ndihen sidomos në të ardhmen. Me këtë akt është tundur tmerrësisht besimi ndaj AKM dhe ndaj tërë procesit të privatizimit. Është reale të pritët se kjo do të ndikojë edhe në zvogëlim të konsiderueshëm të numrit të të interesuarve edhe kur të fillojë procesi i privatizimit. E sa u përket investitorëve dhe blerësve të huaj në procesin e privatizimit në Kosovë konsiderojmë se, pas këtyre ngjarjeve, pjesëmarrja e tyre mund të jetë vetëm iluzion i thjeshtë. Dhe asgjë më tepër.

<#>